REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

Njoftim për aplikim
2018-04-18 09:51:00

Njoftim në lidhje me aplikimin për pozicionin e Shefit të Zyrës së OSBE-së në Tuzla Bosnje-Hercegovinë

Misioni i OSBE-së në Bosnje dhe Herzegovinë ka identifikuar vendin vakant (VNBAHS00845) të Shefit të Zyrës së OSBE-së në Tuzla, Bosnje-Hercegovinë që duhet të plotësohet sa më shpejt që të jetë e mundur: Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë të ftuar të emërojnë kandidatë të kualifikuar për pozicionin e Shefit të Zyrës së OSBE-së në Tuzla të Bosnje-Hercegovinë. Inkurajohet emërimi i kandidateve të kualifikuara femra për këtë pozitë të lartë drejtuese (bashkëlidhur njoftimi i Sekretariatit të OSBE-së).
Kandidati i suksesshëm duhet të ketë aftësi diplomatike të dëshmuara në nivel të lartë. Ai/ajo duhet të jetë një lider me përvojë në udhëheqjen dhe menaxhimin me sukses të një operacioni në terren. Për informacione shtesë lidhur me mandatin dhe funksionimin e Misionit referojuni
https://www.osce.org/mission-to-bosnia-and-herzegovina dhe (https://jobs.osce.org/vacancies
Afati i aplikimit pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të OSBE-së është data 07 Maj 2018, Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë formularin e aplikimit bashkangjitur, një CV në gjuhën angleze dhe gjithashtu të përfshijnë letrën e motivimit, të cilat duhet ti dërgojnë në adresën mira.hoxha@mfa.gov.al deri më 30 prill 2018.